



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 17.10.2024 |
| REFERENC-Ë: | 24/1167/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | "Trofta e Drinit të Bardhë" Sh.p.k, Kultivim, rritje dhe shumim i peshkut, Sigë, Pejë. |
| CC: | Komisioni për Leje Mjedisore |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për Leje Mjedisore |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "Trofta e Drinit të Bardhë" Sh.p.k, Kultivim, rritje dhe shumim i peshkut, Sigë, Pejë, me Nr. Prot.24/1167/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/1167/MMPHI
Datë: 17.10.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Trofta e Drinit të Bardhë" Sh.p.k, me Nr. Prot.24/1167/MMPHI pajiset me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Kultivim, rritje dhe shumim i peshkut, Sigë, Pejë, në ngastrat, nr. 00031-0 dhe nr. 00033-0, zona kadatsrale Sigë, Pejë.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Të respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim te ujit;

- 2.3. Të mirëmbahen hapësirat ku janë deponuar ushqimi i peshqve dhe të mos lejohet të shpërndahen në mjedis;
- 2.4. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.5. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- 2.6. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin, "Trofta e Drinit të Bardhë" Sh.p.k, me Nr. Prot.24/1167/MMPHI, për veprimtarinë: Kultivim, rritje dhe shumim i peshkut, Sigë, Pejë, në ngastrat, nr. 00031-0 dhe nr. 00033-0, zona kadatsrale Sigë, Pejë, konstatohet që operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.


Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit- ARBK;
- Transferin Pëlqim Mjedisor me nr. 20/2512/ZSP/20, të datës: 14.07.2020;
- Leje ndërtimore nga Komuna e Pejës, me nr. 08-351-121315, të datës:16.12.2020;
- Leje Ujore për shfrytëzim, nr. 2938/20-ZSP/2020, të datës:17.09.2020;
- Leje Ujore për shkarkim, nr. 5303/20-ZSP/2020, të datës:27.11.2020.

Bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional, sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si në dispozitiv.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Pejë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së